

VENDIM
Nr. 10, datë 12.4.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Elsa Toska,	anëtare;
Altin Binaj,	anëtar;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Përparim Kalo,	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 12.4.2022, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 17 (G) 2021 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Gëzim Karruli

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 103, datë 1.10.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; nr. 114, datë 25.11.2015, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; nr. 00-2021-504, datë 6.7.2021, të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 29, 31 dhe 135 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 68, 70 e vijuese, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Përparim Kalo, shqyrtoi pretendimet me shkrim të kërkuarit, Gëzim Karruli, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuari, me vendimin nr. 103, datë 1.10.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare” të mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 79 shkronja “c” dhe 22 të Kodit Penal (KP) dhe veprës penale të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuar nga neni 278, pika 4, i KP-së. Në zbatim të nenit 55 të KP-së dhe nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda e ka dënuar përfundimisht kërkuarin me 18 vjet burgim.

2. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. 114, datë 25.11.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-504, datë 6.7.2021, ka vendosur mospranimin e rekursit të nënshkruar vetëm nga mbrojtësi. Sipas arsyetimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, rekursi është paraqitur nga një mbrojtës i palegjitimuar, në kushtet kur tagrat i janë dhënë mbrojtësit nga nëna e kërkuarit dhe jo nga kërkuari.

4. Në datën 19.11.2021 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore, sipas objektit të kërkesës.

5. Kolegji i Gjykatës në datën 14.1.2022 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. **Kërkuari** ka parashtruar se ndaj tij nuk është zhvilluar proces i rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Më konkretisht, në mënyrë të përmbledhur, ai ka pretenduar cenimin e të drejtave të renditura si më poshtë:

6.1 *Të drejtën e aksesit në gjykatë*, pasi Gjykata e Lartë, duke mos pranuar rekursin, ka vepruar në kundërshtim me vendimin e saj unifikues nr. 1/2014, ku është përcaktuar se mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët në kushtet e kufizimit të lirisë personale të të pandehurit do të konsiderohet, për efekt të ligjit, si mbrojtës i zgjedhur. Kërkuari vuan nga sëmundje mendore dhe për këtë shkak nuk ka mundur të zgjedhë vetë mbrojtës, prandaj Gjykata e Lartë duhet ta pranonte mbrojtësin e zgjedhur nga familjarët.

6.2 *Parimin e prezumimit të pafajësisë*, pasi gjatë gjykimit të çështjes në themel gjykatat nuk kanë marrë në shqyrtim provën e ekspertizës mjeko-ligjore, sipas së cilës rezulton që kërkuari në momentin e kryerjes së veprës penale vuante nga probleme të shëndetit mendor. Edhe pse në dosjen gjyqësore ndodhej kartela shëndetësore e kërkuarit, prokuroria nuk ka urdhëruar kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor dhe as gjykata nuk ia ka kthyer aktet prokurorit për këtë qëllim.

6.3 *Parimin e sigurisë juridike*, pasi gjykatat kanë shkelur detyrimin që rrjedh nga neni 132 i Kushtetutës për fuqinë përfundimtare dhe detyruesë të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Ato nuk kanë zbatuar vendimin nr. 9, datë 26.2.2016, të Gjykatës, i cili ka shfuqizuar nenin 278 të KP-së dhe kanë dhënë dënim të bazuar mbi dispozitën ligjore të shfuqizuar.

6.4 *Të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi gjyqtari S.S., pjesëtar i trupës gjyqësore në Gjykatën e Lartë ka qenë edhe në përbërjen e trupës gjyqësore që ka gjykuar çështjen penale ndaj kërkuarit në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

7. Subjekti i interesuar, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

7.1 Për sa i përket aspektit formal të legjitimitetit, nga një vlerësim pamor i tekstit të kërkesës së paraqitur në Gjykatën Kushtetuese, krijohet dyshimi se ajo nuk është nënshkruar nga kërkuari, pasi nënshkrimi nuk duket të jetë i njëjtë në të gjitha faqet e kërkesës. Kërkuari mund të ketë pasur probleme të shëndetit mendor, por fakti që kërkesa në Gjykatë është paraqitur nga mbrojtësi mbi bazën e prokurës së posaçme të nënshkruar nga nëna e kërkuarit, bie në kundërshtim me vendimin e Gjykatës nr. 30, datë 17.6.2010, për sa i përket së drejtës për të zgjedhur përfaqësuesin ligjor.

7.2 Në lidhje me pretendimin për mosvlerësimin si provë nga gjykata të gjendjes mendore të kërkuarit, vërehet se ndryshe nga sa pretendon kërkuari, gjykata e shkallës së parë e ka administruar në gjykim kartelën klinike të shërbimit parësor në burgje në emrin e kërkuarit, si dhe e ka marrë në konsideratë gjendjen e tij mendore kur ka caktuar dënimin. Gjithashtu, gjatë gjykimit nga ana e kërkuarit dhe mbrojtësit të tij nuk është ngritur ndonjë pretendim në lidhje me gjendjen mendore ose përgjegjshmërinë e kërkuarit në kryerjen e veprës penale. Përkundrazi, kërkuari ka kërkuar gjykim të shkurtuar, duke pranuar kështu përgjegjshmërinë e tij në kryerjen e veprave për të cilat akuzohej. Edhe në ankimin e paraqitur në gjykatën e apelit nuk është vënë asnjëherë në diskutim

përgjegjshmëria e kërkuarit në kuptim të nenit 17 të KP-së. Rrjedhimisht, ky pretendim i kërkuarit për vlerësimin e provës nga Gjykata bie jashtë fushëveprimit të shqyrtimit kushtetues.

7.3 Vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së apelit ndaj kërkuarit janë dhënë përpara vendimit nr. 9, datë 26.2.2016, të Gjykatës, sipas të cilit ligjvënësi ka ndryshuar masën e dënimit për njëren nga veprat penale për të cilat është dënuar kërkuari. Gjykata e Lartë nuk i ka shqyrtuar pretendimet në themel, pasi ajo ka vendosur moslegjitimitin e mbrojtësit, që do të thotë se mjetet ligjore të kërkuarit nuk janë shteruar. Duke qenë se pretendimi i kërkuarit për masën e dënimit lidhet me fakte të vërtetuara gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit, ai duhet t'i nënshtrohet paraprakisht shqyrtimit nga sistemi gjyqësor i zakonshëm sipas kreut II, titullit IX, të KPP-së. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuarit është i pabazuar.

7.4 Në prokurën e caktimit të mbrojtësit A.D., që ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, është shprehur vullneti i familjarëve, por jo i kërkuarit. Ky vullnet nuk është konfirmuar nga kërkuari as përpara ndonjë organi procedues dhe as në ndonjërin prej mënyrave që parashikon ligji për këtë veprim ligjor. Rrjedhimisht, edhe ky pretendim i kërkuarit është i pabazuar.

7.5 Pretendimi i kërkuarit për cenimin e të drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme për arsye se gjyqtari S.S., pjesëtar i trupës gjyqësore në Gjykatën e Lartë ka qenë edhe në përbërjen e trupës gjyqësore që ka gjykuar çështjen penale ndaj kërkuarit në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është i bazuar. Pjesëmarrja e gjyqtarit S.S. në shqyrtimin e rekursit përbën një nga rastet e papajtueshmërisë me funksionin e gjyqtarit në gjykim, për shkak të pjesëmarrjes së tij në të njëjtin procedim, sipas nenit 15, pika 1, të KKP-së.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

8. Kërkuari ka pretenduar se legjitimohet për t'u drejtuar Gjykatës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet që kundërshtohen në Gjykatën Kushtetuese.

9. Subjekti i interesuar ka pretenduar se për sa i përket aspektit formal të legjitimitit, nga një vlerësim i kërkesës së paraqitur në Gjykatë, krijohet dyshimi se ajo nuk është nënshkruar nga kërkuari, pasi nënshkrimi nuk duket të jetë i njëjtë në të gjitha faqet e kërkesës. Pavarësisht se kërkuari mund të ketë pasur probleme të shëndetit mendor dhe kërkesa në Gjykatë është paraqitur nga mbrojtësi mbi bazën e prokurës së posaçme të nënshkruar nga nëna e kërkuarit, kjo procedurë bie në kundërshtim me jurisprudencën e vetë Gjykatës, konkretisht me vendimin e saj nr. 30, datë 17.6.2010, që trajton të drejtën për të zgjedhur përfaqësuesin ligjor.

10. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me vënien në lëvizje të një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "F" dhe 134, pika 1, shkronja "I" dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

11. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative dhe mjafton të mos plotësohet njëri prej kriterëve që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

13. Në lidhje me legjitimimin formal të kërkuarit, Gjykata konstaton se në rastin konkret, kërkesa e paraqitur plotëson kriterin formal të parashikuar në nenin 27, pika 2, shkronja “ë”, të ligjit nr. 8577/2000. Subjekti i interesuar nuk ka paraqitur asnjë provë, ndërkohë që mund të kishte konstatuar vetë vërtetësinë e nënshkrimit të kërkuarit në kërkesën e paraqitur në Gjykatë, nëse kishte dyshime. Po kështu, për sa i përket pretendimit të subjektit të interesuar se prokura e posaçme e mbrojtësit është nënshkruar nga e ëma e kërkuarit, rezulton se kërkesa e paraqitur në Gjykatë është nënshkruar nga vetë kërkuari, i cili është njoftuar më pas nga Gjykata për shqyrtimin e kërkesës së tij. Për më tepër, mbrojtësi ligjor në rastin konkret (A.D.), e ka ndjekur çështjen e kërkuarit në të gjitha instancat gjyqësore, duke mos krijuar dyshime lidhur me marrëdhënien e përfaqësuesit ligjor me kërkuarin.

14. Për këto arsye, Gjykata çmon se kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në proceset gjyqësore, për të cilat janë dhënë vendimet objekt kundërshtimi në Gjykatë.

15. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa në Gjykatën Kushtetuese mund të paraqitet brenda 4 muajve nga konstatimi i cenimit. Në rastin në shqyrtim konstatohet se vendimi që kërkohet të shfuqizohet është vendimi i Gjykatës së Lartë, i cili mban datën 6.7.2021, kurse kërkesa në Gjykatë është depozituar nga kërkuari (me postë) në datën 4.11.2021, pra brenda afatit ligjor 4-mujor. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuari legjitimohet *ratione temporis*.

16. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuarit hyjnë *prima facie* në juridiksionin kushtetues, prandaj ato do të shqyrtohen në vijim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatë

17. Kërkuari ka pretenduar se i është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë për shkak se Gjykata e Lartë, duke mos pranuar rekursin, ka vepruar në kundërshtim me vendimin e saj unifikues nr. 1/2014, në të cilin është përcaktuar se mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët në kushtet e kufizimit të lirisë personale të të pandehurit do të konsiderohet, për efekt të ligjit, si mbrojtës i zgjedhur. Kërkuari vuan nga një sëmundje mendore dhe për këtë shkak nuk ka mundur të zgjedhë vetë mbrojtës, prandaj Gjykata e Lartë duhej ta pranonte mbrojtësin e zgjedhur nga familjarët.

18. Subjekti i interesuar ka prapësuar se vullneti i shprehur në prokurën e caktimit të mbrojtësit A.D., që ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, është ai i familjarëve dhe jo i kërkuarit, çka bie në kundërshtim me vendimin nr. 30, datë 17.6.2010, të Gjykatës, për sa i përket së drejtës për të zgjedhur përfaqësuesin ligjor. Ky vullnet nuk është konfirmuar nga kërkuari as përpara ndonjë organi procedues dhe as në ndonjë nga format që ligji njeh për këtë veprim ligjor. Për këtë arsye pretendimi i kërkuarit është i pabazuar.

19. Në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e gjyqimit të drejtë dhe publik brenda afatit të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik.

20. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr.*

12, datë 9.3.2021; nr. 56, datë 25.7.2017; nr. 21, datë 20.3.2017; nr. 52, datë 14.11.2014, të Gjykatës Kushtetuese).

21. Për sa më lart, Gjykata çmon se detyrimi për respektimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga organet e pushtetit publik duhet të zbatohet edhe në rastin e personave të cilëve u është kufizuar liria dhe kjo e drejtë është e pandashme, e patjetërsueshme dhe e pacenueshme. Në këtë kuptim, organeve të pushtetit publik u lindin detyrime shtesë për të respektuar të drejtat kushtetuese për këtë kategori të veçantë, nisur nga premisa se nenet 27 dhe 28 të Kushtetutës parashikojnë garanci specifike, ku ritheksohet në mënyrë të veçantë se çdo person, të cilit i është hequr liria, ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij.

22. Gjykata, për sa u përket vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë, është shprehur se Kushtetuta i ka dhënë kësaj të fundit autoritetin të njësojë ose ndryshojë praktikën gjyqësore, pra të mbajë qëndrime në çështje të veçanta, me qëllim unifikimin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme. Qëllimi i Gjykatës nuk është të vërë në diskutim vlerën që kanë vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë në rendin juridik dhe as detyrimin ligjor që kanë gjykatat më të ulëta që të marrin parasysh dhe zbatojnë në çështje analoge zgjidhjet e dhëna në këto vendime (*shih vendimet nr. 26, datë 22.5.2015; nr. 6 datë 17.2.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në çështjen konkrete Gjykata vëren se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit me vendimin nr. 00-2021-504, datë 6.7.2021, duke e konsideruar atë si të paraqitur nga një mbrojtës i palegjitimuar, në kushtet kur tagrat i ishin dhënë mbrojtësit nga nëna e kërkuarit dhe jo nga kërkuari. Më konkretisht, në këtë vendim, Gjykata e Lartë, bazuar kryesisht në vendimin e saj unifikues nr. 1/2014 (paragrafi 54) ka mbajtur qëndrimin, se: *"I pandehuri lejohet që personalisht të delegojë të drejtën për të bërë ankim të mbrojtësi. Akti i delegimit mund të jetë në të njëjtin akt me të cilin bëhet zgjedhja e mbrojtësit, ose në një akt të veçantë. I pandehuri lejohet gjithashtu të delegojë të drejtën për të bërë ankim të mbrojtësi, duke e ushtruar këtë vullnet nëpërmjet delegimit të një i afërm. I afërmi nuk zgjedh mbrojtës dhe as nuk delegon të drejtën për ankim në mënyrë autonome. Ankimi i mbrojtësit të zgjedhur nga të afërmit lejohet vetëm nëse provohet, se: i. zgjedhja e mbrojtësit; dhe ii. delegimi i mbrojtësit për të ushtruar ankim, është rezultat i vullnetit të plotë dhe eksplisit të titullarit të kësaj të drejte, që është i pandehuri. Mënyra dhe forma e përcaktuar nga ligji për këtë delegim është ajo e përcaktuar në pikën 2 të nenit 48 të K. Pr. Penale."*

24. Gjykata konstaton se në rastin në fjalë kërkuari gjendet në kushtet e kufizimit të lirisë personale në burg dhe sipas nenit 48, pika 3, të KPP-së: *zgjedhja e mbrojtësit për personin e (...) dënuar me burgim, derisa ky person nuk e ka bërë vetë zgjedhjen, mund të bëhet nga një i afërm i tij, në format e parashikuara nga paragrafi 2"*. Megjithatë, Gjykata e Lartë në vendimin e saj nuk e ka trajtuar çështjen duke u bazuar në interpretimin e nenit 48, pika 3, të KPP-së dhe në paragrafin 25 të vendimit të saj unifikues nr. 1/2014, të cilat i përgjigjen situatës faktike konkrete, por i është referuar paragrafit 54 të vendimit unifikues nr. 1/2014. Në rastin konkret nuk jemi përpara situatës ku i pandehuri i fshihet drejtësisë ose është në mungesë, por jemi në kushtet e pamundësisë së kërkuarit për të zgjedhur mbrojtës për arsye të kufizimit të lirisë së tij personale. Gjykata vlerëson se kjo qasje ndaj nenit 48 pika 3 e KPP-së në çështjen konkrete i ka kufizuar kërkuarit aksesin substancial në gjykim, pasi nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij të ngritura në rekurs. Kjo e fundit duket se ka mbajtur një qëndrim formalist për sa i përket mbrojtësit të zgjedhur nga nëna e kërkuarit, duke mos shkuar përtej një kontrolli formal të prokurës, në drejtëm të verifikimit nëse zgjedhja e mbrojtësit nga nëna e të gjykuarit ishte rezultat edhe i vullnetit të plotë të këtij të fundit. Në rastin konkret, me qëndrimin e saj formalist në lidhje me verifikimin e legjitimitetit të mbrojtësit, Gjykata e Lartë i ka kufizuar kërkuarit aksesin substancial në gjykim, duke e bërë të pamundur shqyrtimin në themel të shkaqeve të rekursit.

25 Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykim është i bazuar.

B.2. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme

26. Kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme për arsye se gjyqtari S.S., pjesëtar i trupit gjykues në Gjykatën e Lartë që ka shqyrtuar rekursin ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka gjykuar çështjen penale ndaj kërkuesit në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

27. Subjekti i interesuar ka parashtruar se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme për arsye se gjyqtari S.S., pjesëtar i trupit gjykues në Gjykatën e Lartë ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka gjykuar çështjen penale ndaj kërkuesit në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është i bazuar. Pjesëmarrja e gjyqtarit S.S. në shqyrtimin e rekursit përbën një nga rastet e papajtueshmërisë me funksionin e gjyqtarit në gjykim, për shkak të pjesëmarrjes së tij në të njëjtin procedim, sipas nenit 15, pika 1, të KKP-së.

28. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimin nr. 49, datë 10.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në kuptim të nenit 42, pika 2 të Kushtetutës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili, në thelb, kërkon të provuarit e faktit se bindja personale e një gjyqtari ka ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme ka rëndësi. Për rrjedhojë, kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm (*shih vendimin nr. 49, datë 10.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Gjykata ka çmuar se paragjykimimi eventual për paanësinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën kur gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt. Në shtetin e së drejtës, kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë (*shih vendimet nr. 6, datë 2.3.2018; nr. 46, datë 19.7.2016; nr. 49, datë 10.7.2015; nr. 21, datë 29.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Në funksion të këtij parimi të rëndësishëm kushtetues neni 15, pika 1, i Kodit të Procedurës Penale parashikon shprehimisht, se: *“Gjyqtari që ka dhënë ose ka marrë pjesë në dhënien e vendimit në një shkallë të procedimit nuk mund të ushtrojë funksionet e gjyqtarit në shkallët e tjera, as të marrë pjesë në rigjykim pas prishjes së vendimit.”*

32. Nga sa më sipër, është më se e qartë që parimi i paanshmërisë në gjykim, edhe në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit, pra edhe në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë. Kjo do të thotë se gjyqtari i Gjykatës së Lartë nuk mund të jetë anëtar i një kolegji nëse, për të njëjtën çështje, ka marrë pjesë në dhënien e një vendimi në një shkallë të mëparshme të procesit.

33. Në çështjen konkrete gjyqtari S.S. ka qenë pjesëtar i trupit gjykues në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, e cila e ka shpallur fajtor kërkuesin për kryerjen e veprave penale të “Vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare” dhe të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe

municionit”, duke e dënuar përfundimisht me 18 vjet burgim. Nga verifikimet në dosjen gjyqësore, sipas procesverbalit të mbajtur në datën 5.7.2021 në Gjykatën e Lartë, rezulton se gjyqtari S.S., për shkak të pjesëmarrjes së tij në trupin gjykues që ka gjykuar kërkuesin në shkallë të parë, është zëvendësuar me gjyqtarin E.P. Gjykata e Lartë, në këtë procesverbal për plotësimin e trupit gjykues që do të shqyrtonte çështjen e kërkuesit ka pohuar, se: “*Nga verifikimet fizike të dosjes (...) rezulton se gjyqtarët S.S. dhe K.K., kanë qenë pjesë e trupës gjykuese në vendimin nr. 103, datë 1.10.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, fakt i cili i përjashton nga gjykimi i çështjes (...), si dhe gjyqtarja A.B. ka qenë pjesë e trupës gjyqësore në vendimin nr. 114, datë 25.11.2015, në Gjykatën e Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, fakt i cili e përjashton nga gjykimi i çështjes së lartpërmendur.*”.

34. Në kundërshtim me sa është konstatuar më lart, gjyqtari S.S. ka marrë pjesë në trupin gjykues të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili ka gjykuar dhe vendosur mospranimin e rekursit. Gjykata vëren se megjithëse vlerësimi që gjyqtari S.S. i ka bërë rekursit në Gjykatën e Lartë ka qenë vetëm formal, dyshimi i kërkuesit për njëanshmëri në shqyrtimin e çështjes së tij në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë të mbledhur në dhomën e këshillimit është i bazuar. Gjykata e Lartë duhet të kishte shmangur pjesëmarrjen e gjyqtarit S.S. në Kolegjin Penal, sidomos për faktin se ajo e ka pranuar heqjen dorë të këtij gjyqtari madje ka caktuar edhe gjyqtarin për zëvendësimin e tij. Në këto kushte, pjesëmarrja e gjyqtarit S.S. në gjykimin e çështjes në Gjykatë të Lartë, pavarësisht se ai nuk është shprehur për themelin e çështjes, krijon dyshim objektivisht të bazuar te kërkuesi për paanshmërinë e tij.

35. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme është i bazuar.

B.3. Për pretendimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë

36. Kërkuesi ka pretenduar se është cenuar *parimi i prezumimit të pafajësisë*, pasi gjatë gjykimin të çështjes në themel gjykatat nuk kanë marrë në shqyrtim provën e ekspertizës mjekoligjore, sipas së cilës rezulton që kërkuesi në momentin e kryerjes së veprës penale vuante nga probleme të shëndetit mendor. Edhe pse në dosjen gjyqësore ndodhej kartela shëndetësore e kërkuesit, prokuroria nuk ka urdhëruar kryerjen e ekspertimit mjekoligjor dhe as gjykata nuk ia ka kthyer aktet prokurorit për këtë qëllim.

37. Subjekti i interesuar ka prapësuar se ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, gjykata e shkallës së parë e ka administruar në gjykim kartelën klinike të shërbimit parësor në burgje në emrin e kërkuesit, madje e ka marrë në konsideratë gjendjen e tij mendore në caktimin e dënimit. Gjithashtu, nga ana e kërkuesit dhe mbrojtësit të tij nuk është ngritur në gjykim ndonjë pretendim në lidhje me përgjegjshmërinë e kërkuesit në kryerjen e veprës penale ose gjendjen e tij psikike. Përkundrazi, kërkuesi ka kërkuar gjykim të shkurtuar, duke pranuar faktin e përgjegjshmërisë së tij penale në kryerjen e veprave për të cilat akuzohej. Edhe në ankimin e paraqitur në gjykatën e apelit nuk është vënë asnjëherë në diskutim përgjegjshmëria e kërkuesit, në kuptim të nenit 17 të KP-së. Rrjedhimisht, ky pretendim i kërkuesit për vlerësimin e provës nga Gjykata Kushtetuese bie jashtë fushëveprimit të shqyrtimit kushtetues.

38. Gjykata është shprehur se prezumimi i pafajësisë është një nga elementët përbërës të procesit të rregullt ligjor. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza (*shih vendimet nr. 12, datë 24.4.2018; nr. 68, datë 14.11.2016; nr. 19, datë 2.4.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Në çështjen konkrete, Gjykata vlerëson se për shkak të cenimit të së drejtës së aksesit substancial, kërkuesi nuk ka marrë përgjigje nga Gjykata e Lartë për pretendimin e cenimit të parimit

të prezumimit të pafajësisë. Gjykata e Lartë duhet t'i jepte përgjigje këtij pretendimi të ngritur nga kërkuesi, duke pranuar ekzaminimin e gjendjes mendore të tij, që është kërkuar nga pala gjatë gjykimit në gjykatat e faktit, për të përcaktuar shkallën e përgjegjshmërisë penale të tij. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson të mos ndalet në analizimin e këtij pretendimi, për sa kohë çështja do të merret përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, e cila, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit dhe si kontrolluese e respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, do t'i japë përgjigje të arsyetuar pretendimit të ngritur në rekurs nga kërkuesi.

B.4. Për parimin e sigurisë juridike

40. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat, duke shkelur detyrimin që rrjedh nga neni 132 i Kushtetutës për fuqinë përfundimtare dhe detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, kanë cenuar parimin e sigurisë juridike. Sipas tij, kjo shkelje lidhet me moszbatimin prej tyre të vendimit nr. 9, datë 26.2.2016, të Gjykatës, i cili ka shfuqizuar nenin 278 të KP-së, dhe, për rrjedhojë, kanë dhënë dënim duke u bazuar në dispozitën ligjore të shfuqizuar.

41. Subjekti i interesuar ka prapësuar se vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së apelit janë marrë përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 9, datë 26.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese. Në kushtet kur Gjykata e Lartë nuk i ka shqyrtuar pretendimet në themel për shkak të moslegjitimitit të mbrojtësit, në rastin konkret nuk janë shteruar mjetet ligjore për shqyrtimin në themel të pretendimeve të kërkuesit. Nga ana tjetër, ky pretendim i kërkuesit për masën e dënimit lidhet me fakte të vërtetuara gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit dhe për këtë arsye ai duhet t'i nënshtrohet paraprakisht shqyrtimit nga sistemi gjyqësor i zakonshëm, sipas kreut II, titullit IX, të KPP-së.

42. Nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës shprehen qartësisht në lidhje me forcën detyruese që vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë edhe gjykatat. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrim kushtetues. Ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Si të tilla, përbëjnë jurisprudence kushtetuese, dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Efekti detyrues shtrihet tek argumentet thelbësore të vendimit, që përbëjnë edhe *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë (*shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021, nr. 49, datë 3.7.2017; nr. 15, datë 1.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

43. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se kërkuesi është dënuar, ndër të tjera, për kryerjen e veprës penale të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuar nga neni 278, pika 4, i KP-së në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale (2014).

44. Gjykata konstaton se vendimet gjyqësore të gjykatave të faktit janë dhënë përpara se Gjykata Kushtetuese të shfuqizonte paragrafin 5 të nenit 278 të KP-së, përkatësisht në datat 1.10.2015 (vendimi gjyqësor i shkallës së parë) dhe 25.11.2015 (vendimi gjyqësor i apelit). Po kështu, edhe rekursi në Gjykatën e Lartë është ushtruar në datën 23.12.2015, pra përpara datës së hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Në këto kushte, kur janë dhënë vendimet gjyqësore nga gjykatat e faktit për shpalljen fajtor dhe dënimin e kërkuesit, ky vendim i Gjykatës Kushtetuese nuk kishte hyrë në fuqi.

45. Në kohën e shqyrtimit të rekursit (datë 6.7.2021) në Gjykatën e Lartë, si vendimi nr. 9, datë 26.2.2016 i Gjykatës, ashtu edhe ndryshimet ligjore që u bënë në zbatim të këtij vendimi (ligjet nr. 82/2016 dhe nr. 44/2019), të cilat ndryshuan paragrafin 5 të nenit 278 të KP-së, kishin hyrë në fuqi. Pra, në kohën e shqyrtimit të rekursit ishte në fuqi një dispozitë ligjore penale favorizuese për kërkuesin, për sa i përket masës së dënimit. Siç është përmendur edhe më lart, në kohën e dënimit të kërkuesit nga gjykatat e faktit, masa e dënimit për veprën penale të parashikuar nga paragrafi 5 i nenit 278 të KP-së ishte nga 7–15 vjet burgim, ndërsa pas ndryshimeve ligjore masa e dënimit ishte më favorizuese, nga 5–7 vjet burgim.

46. Bazuar në sa më sipër, duke qenë se në rastin konkret çështja ishte ende në shqyrtim në Gjykatën e Lartë dhe dënimi penal i dhënë ndaj kërkuesit lidhej drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit të shfuqizuar (neni 278, paragrafi 5, i KP-së), Gjykata çmon se vendimi i saj nr. 9, datë 26.2.2016 duhej të ishte trajtuar nga Gjykata e Lartë, në kuadër të efektit prapaveprues të tij në këtë rast. Kjo do t'i shërbente edhe garantimit të parimit të sigurisë juridike në fushën penale, i cili sipas jurisprudencës kushtetuese është një nga elementet e shtetit të së drejtës dhe duhet të mbahet parasysh nga ligjvënësi në përcaktimin e dënimit, çka i mundëson gjyqtarit të bëjë gjykim të drejtë dhe proporcional në raste konkrete (*shih vendimin nr. 9, datë 26.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i kërkuesit është i bazuar.

47. Si përfundim, Gjykata vlerëson se në rastin konkret është zhvilluar proces i parregullt ligjor si rezultat i cenimit të së drejtës për akses substancial në gjykatë dhe të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2021-504, datë 6.7.2021, të Gjykatës së Lartë si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
 3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.
 4. Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 12.4.2022.

Shpallur më 16.5.2022.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Altin Binaj, Elsa Toska, Përparim Kalo, Sandër Beci